

AWARDS TIFF 2014



BEST AUDIENCE

CROSSING by Amos Ezra Katz | Fiction | Singapore

INTERNET VOTE

BEST FEATURE - TERMITARIA by Joseph Israel Laban | Philippines

BEST SHORT FICTION - CHILD K by Roberto De Feo & Vito Palumbo | Italy

BEST SHORT ANIMATION - WHAT REMAINS by Liv Scharbatke | Germany

BEST SHORT DOCUMENTARY - SILENT CHAMPIONS by Lulzim Sula | Albania

BEST SHORT EXPERIMENTAL - HAPPY THOUGHTS by Layke Anderson | UK

BEST FILM IN ALBANIAN - THE DIARY OF DREAMS by Xhulio Joka | Fiction

MEDIA AWARD

The Jury composed by Jonida Shehu, Rezear Xhaxhiu and Albert Dumani

"VRASJA E NJË FEMIJE VRET GJITHË FËMIJËT E BOTËS "

Një dramë familjare që rrëfen me gjithë fuqinë e saj, se si ajo u kthye në dramën e një kombi,

kur ngjarja i shërbeu regjimit hitlerian për atë që më pas do të shndërrohej në fushatën më tragjike të njerëzimit: shfarosjen e fëmijëve të sapolindur me aftësi të kufizuara që konsideroheshin si të padenjë për racën ariane.

Çmenduria e një babai që donte domosdoshmërisht një djalë të fuqishëm për të projektuar të ardhmen e familjes së tij ngacmoi çmendurinë pa limit të një lideri si Hitleri, i cili më pas do ta kthente në obsesion idenë për një komb dhe racë superiore.

Përmes kësaj ngjarjeje të vërtetë del në pah ironia e historisë në vetvete, se ngjarje që kanë ndryshuar rrjedhën e fatit të miliona njerëzve kanë nisur nga një ide e çmendur dhe banale, e një personi të panjohur në një vend të humbur .

Ky film nxjerr në sipërfaqe faktin se ngjarjet e mëdha dhe tronditëse të një kombi nganjëherë dhe jo rastësisht e kanë zanafillën nga çmenduritë dhe pasionet e vogla të njerëzve të zakonshëm. E gjithë kjo ironi e dhimbshme historike vjen te “CHILD K” përmes një gjuhë të thjeshtë filmike në pjesën e parë, por që tregon qartë jetën e zakonshme të një fshatari gjerman , për të kaluar me pas në një tjetër dimension, që shkon paralel me përmasat dramatike që merr historia e fshatarit Richard Kretschkopf.

Dhe ky çmim shkon për:

CHILD K by Roberto De Feo & Vito Palumbo | Fiction | Italy

“THE MURDER OF A CHILD, KILLS ALL THE CHILDRENS OF THE WORLD“

One family drama which recounts with all power how it returned to the drama of a nation, when the event served the Hitler regime for what would become the most tragic humanity campaign: the annihilation of the newborn children’s with disabilities, perceived as ignoble of the Aryan

race. The madness of a father who definitely wanted a son potent enough to project the future of his family, urged the madness of a leader like Hitler who later would turn this idea in an obsession, the idea of a superior nation and race. Through this real event emerges the irony of the history itself that events that had changed the course of the fate of millions of people, have started from the crazy and banal idea of an unknown person in an unknown country. This movie brings to the surface the fact that large and shocking events of a nation and not coincidentally sometimes originate from the small passions of ordinary people. Throughout this painful historical irony comes in "child k" through the use of a simple language but that clearly shows the usual life of a German peasant, switched to another dimension that runs simultaneously with the dramatic story of the peasant Richard Kretschkopf.

And this award goes to:

CHILD K by Roberto De Feo & Vito Palumbo | Fiction | Italy

BEST FILM IN ALBANIAN

The Jury composed by Odeta Çunaj, Sonila Demi dhe Kamuran Goranci

Për gjetjen e strukturës dhe stilit vizual krejtësisht origjinal dhe koherent në shprehjen e një revolte komplekse dhe abstrakte brenda individit, duke e bërë këtë të kuptueshme e të prekshme në të gjitha kohërat. Ky çmim shkon për:

PASIGURIA nga Lediona Kasapi | Experimental

For finding a structure and visual style both original and coherent in expressing a complex and abstract inner revolt, making it comprehensible and touchable always.

INSECURITY by **Lediona Kasapi** | Experimental

BEST FIRST FILM RON HOLLOWAY

By the organizers

Film fluid me një ritëm dhe temp të shkëlqyer, një rrëfim që rrjedh natyrshëm dhe arrin ta bëjë secilin shikues të lidhet me ngjarjen dhe të përjetojë te gjitha ndryshimet emocionale që përjeton personazhi kryesor. Një mënyrë tejet e sofistikuar dhe inteligjente e paraqitjes së “ngrohtësisë” së nevojave emotive të njeriut që i kundërvihet “ftohtësisë” burokratike të sistemit. Ky çmim i jepet:

GROUNDED by **Alexis Michalik** | Fiction | France

Fluid film with an excellent rhythm and pace, a naturally flowing narrative that manages to create a connection between each viewer with the story so that he can experience the emotional changes the main character experiences. A highly sophisticated and intelligent presentation of emotional "warmth" that human needs that opposes the "coldness" bureaucratic system. This award goes to:

GROUNDED by **Alexis Michalik** | Fiction | France

BEST BALKAN FILM

Curated by AltCine and Elektra Venaki

Për saktësinë e tij në përshkrimin e realitetit në lidhje me problematikat adoleshenciale, për skenarin, stilin e narracionit dhe ritmin duke marrë parasysh kushtet në të cilat produksionet multi-ballkanike realizohen. Çmimi i Filmit më të mirë Ballkanik i shkon filmit:

HOLIDAY AT THE SEASIDE nga **Cristina Grosan** | Fiction | Bosnia- Herzegovina

i prodhuar nga “Qyteti i Sarajevos” me një grup xhirimi boshnjak dhe regjisore rumune.

For its accuracy in depicting the reality and the concerns of the adolescence, for the scenery, narrative style and pace in addition to the multi-Balkan conditions of production, the Balkan Best film award goes to:

HOLIDAY AT THE SEASIDE by **Cristina Grosan** | Fiction | Bosnia- Herzegovina

produced by City of Sarajevo, with Bosnian crew and Romanian Director

INTERNATIONAL SHORT CATEGORY

The Jury composed by Sasho Pavlovski, Daniele Greco and Kushtrim Bekteshi

BEST SHORT EXPERIMENTAL

Duke përdorur metoda eksperimentale, nëpërmjet një stili të pasur ekspresiv, autori mrekullisht ia del të nxjerrë në pah të gjitha gjërat e vogla që nganjëherë na duken të parëndësishme. Përmes jetës së një çifti të dashuruar, ne mund të kapim të gjitha detajet, emocionet, afeksionin, lëvizjet, qe i japin kuptim më të thellë ëndrrave të tyre.

Ky çmim shkon për:

y2o {i distiluar} by Dominique T. Skoltz | Kanada

Using experimental tools, with a rich expressive style, the author marvelously succeeds to point out all the small things that sometimes we think are not important. Through the life of a loving couple, we are able to see all the detailed touches, emotions, affections, movements that give deeper meaning to their dreams.

y2o {distilled} by Dominique T. Skoltz | Canada

BEST SHORT ANIMATION

Çdo individ është unik në këtë botë. Ne jemi të gjithë një mrekulli e papërsëritshme. Të shkurtër apo të gjatë, të dobët apo të fortë, të bukur apo më pak të bukur, ne vimë në këtë botë si fitimtarë të një gare të gjatë dhe të mundimshme, mes miliona spermatozoidësh. Ja pse ne

duhet t'i gezohemi kësaj jete të bukur. Kjo histori e shkëlqyer dhe optimiste, e krijuar nga një autor fantastik, përcillet tek audienca nëpërmjet animacionit mbresëlenës 3D. Ky çmim shkon për:

JETA ËSHTË E BUKUR NGA Ben Brand | Animation | Hollandë

Every individual is unique in this world. We are all one unprecedented miracle. Short or tall, weak or strong, beautiful or less beautiful, we came to this world as winners of long and tough race of million of sperms. That is why we should enjoy this beautiful life. This wonderful and optimistic story is transferred to the audience by an excellent author, through an impressive 3D animation. This award goes to:

LIFE IS BEAUTIFUL by Ben Brand | Netherlands

BEST SHORT DOCUMENTARY

Autori i këtij filmi dokumentar në një mënyrë të shkëlqyer ka arritur të na paraqesë një histori të thellë emotive nëpërmjet poezisë së imazheve, në heshtje, pa përdorur fjalë, por duke arritur efektin e klithjes. Filmi reflekton mrekullinë e aktit të faljes përmes personazhit, i cili pas gjithë

atyre torturave të tmerrshme që ka përjetuar, në vend të hakmarrjes dhe urrejtjes ai zgjedh jetën dhe dashurinë. Dokumentari më i mirë shkon për:

VRAGËT E KAMBOXHIAS nga Alexandre Liebert | Francë

The author of this documentary film, succeeds in an extraordinary way, through a poetry of picture, to expose one deep and emotional story, without words, in silence, but louder than any scream. The film reflects the greatness of the act of forgiveness, through a character, which besides all of the horrible tortures conducted on him, chooses life and love instead of revenge and hatred. The best documentary goes to:

SCARS OF CAMBODIA by Alexandre Liebert | France

BEST SHORT FICTION

Trajtim i guximshëm dhe kreativ i temës së racizmit, ksenofobisë, agresionit, intolerancës dhe paragjykitimit... Ato duken sikur janë pesë gishtat e një dore të mbledhur grusht, që godet fuqishëm publikun duke e ballafaquar me këto probleme aktuale që po shqetësojnë shoqërinë moderne në të gjithë globin. Individit i vënë nën presionin e këtyre rrethanave nuk është në gjendje për të bërë një zgjedhje racionale, kështu që fati tragjik i tij është i pashmangshëm.

RED HULK nga Asimina Proedrou | Greqi

Brave and creative treatment of themes like racism, xenophobia, aggression, intolerance and prejudice... they look like five fingers of one hand enclosed into a fist which blows a strong hit to the audience and confronts it to the actual problem which disturbs the modern society in the whole world. The individual who is pressed by these circumstances is not in condition to make a rational choice, so its tragic destiny is predicted.

RED HULK by Asimina Proedrou | Greece

FEATURE CATEGORY

The Jury composed by Elma Tataragic, Regina Longo and Gabor Pinter

BEST EDITING “LUC BARNIER”

Kërkimi i dashurisë dhe i punës mund të jetë paralizues, por në duart e sigurta të kësaj historie mund të jetë plot me energji kinetike, që fton spektatorin të mbajë ritmin me zhvillimin filozofik të protagonistes. Për reflektimin e hollësishëm të studiuar mirë, çmimi për montazhin më të mirë i

shkon:

Daniel Stephan

Për filmin □ LOVE ME (Dashuromë) nga Philipp Eiccholtz | Fiction | Germany

The search for love and employment can be paralyzing, but in the right hands this type of story can be full of kinetic energy that invites the viewer to keep pace with the philosophical development of the protagonist. For its fresh take on the bildungsroman, the award for best editing goes to:

Daniel Stephan

for the film LOVE ME (Liebe Mich) by □ Philipp Eiccholtz | Fiction | Germany

BEST CINEMATOGRAPHY

Për përjasjen e mençur dhe intriguese, në perceptimin e frymëzimit të marrë nga pikturat e së shkuarës në një mënyrë unike të të parit botën, çmimi Fotografia më e mirë në Festivalin e Filmit të Tiranës i shkon:

drejtorit të fotografisë Jimmy Gimferrer

për filmin **FALLING STAR**

For the mature and intriguing approach to transposing the inspiration offered by period paintings into a unique visual world, The Best Cinematography Award of the Tirana Film Festival goes to:

Cinematographer Jimmy Gimferrer

for the film **FALLING STAR** | Fiction | Spain

BEST SCREENPLAY

Çmimi i skenarit më të mirë i jepet filmit që sjell një histori të rëndësishme për shoqërinë tonë gjithmonë e përkushtuar drejt suksesit dhe fitimprurjes materiale. Ky skenar është i përpunuar, i thellë, me një ekuilibër ndërmjet jetës profesionale dhe personale të personazhit kryesor, që na ve në tension të ndjeshëm në çdo fushë të jetës, ndërkohë që ai vetë zhytet në dëshpërim. Çmimi i shkon për:

Antonio Morabito, Michele Pellegrini dhe Amedeo Pagani

Për filmin **SHITËSI I ILAÇEVE**

The Best Script Award is given to the film, which brings an important story for our societies preoccupied with material gain and success. This screenplay is elaborate, deep, with a nice balance of character's professional and personal life, building palpable tension in each sector as he shifts to desperation. The Award goes to:

Antonio Morabito, Michele Pellegrini, Amedeo Pagani

for the film **THE MEDICINE SELLER** (IL VENDITORE DI MEDICINA) | Fiction | Italy

BEST DIRECTOR

Për përdorimin e rafinuar të simboleve dhe ironisë në përshkrimin e vetmisë dhe izolimit në një film historik, çmimi për regjinë më të mirë në Tirana Film Festival shkon për:

Luis Miñarro

për filmin e tij **FALLING STAR**

For the refined use of symbols and irony in depicting solitude and isolation in a period drama the best directing award of the Tirana Film Festival goes to:

Luis Miñarro

for his film **FALLING STAR** | Fiction | Spain

BEST FEATURE FILM

Çmimi për Filmin më të mirë i shkon filmit që jo vetëm është i realizuar mirë, plot stil dhe me një histori emocionuese, por reflekton një portret social të shoqërisë së korruptuar në të cilën përfitimi vendoset mbi dekadencën njerëzore. Ky film është një portret i hidhur il korrupsionit të ndërmarrjeve i mbështetur nga një lojë shumë e mirë aktorësh, skenar të shkruar me kujdes dhe mbi të gjitha me mesazhe të qarta. Çmimi shkon për:

SHITËSI I ILAÇEVE

prodhuar nga Amedeo Pagani me Regji nga Antonio Morabito

The Best Film Award goes to the film which is not only a well made, stylish and exciting drama, but also a socially engaged portrayal of a corrupt society in which profit is put above human decency. This film is a bitter portrait of corporate corruption, backed by outstanding performances, well-written script and above all important message. The award goes to:

THE MEDICINE SELLER (IL VENDITORE DI MEDICINA)

produced by Amedeo Pagani & directed by Antonio Morabito

{artsexylightbox path="images/stories/tiff2014/awards"/}